

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL.-KZZ. Nr. 24/2011
27 dhjetor 2011
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Charles L. Smith III. si Kryetar i kolegjit,
Gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia dhe
Gjyqtari i Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

në praninë e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, i cili vepron në cilësinë e procesmbajtësit, në seancën e mbajtur më 27 dhjetor 2011, në lëndën penale kundër:

A. **Z**, emri i atë atit J. emri i vajzërisë së nënës F. A. , i lindur më **× × ×** në fshatin **× × ×**, komuna e Gjilanit, me banim në rrugën me **× × ×** **× × ×**, komuna e Prishtinës, Kosovë, Shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i **× × ×** fëmijëve, me shkollim të përfunduar, me gjendje të mirë ekonomike, numri i letërnjoftimit **× × ×**, pa dënime të mëhershme, në arrest shtëpiak prej 30 qershor 2008 deri më 11 gusht 2008,

I akuzuar sipas aktakuzës PP. Nr. 1916/09, të ushtruar nga Prokurori Publik Komunal në Prizren më 20 gusht për veprën penale **Dhënie e Ryshfetit** në pajtueshmëri me Nenin 344 paragrafi 1 të Kodi të Përkohshëm Penal të Kosovës (tash e tutje KPPK);

I shpallur fajtor për veprën penale Dhënia e ryshfetit si ndërmjetësues në pajtueshmëri me Nenin 344 paragrafi 1 të KPPK dhe i dënuar në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) vjet burgim dhe një gjobë prej dy mijë (2,000) Euro me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Komonale në Prizren P. 385/10, të datës 25 mars 2010 dhe me aktgjykimin e shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut në Prizren KP. 160/10, të datës 30 korrik 2010,

Duke vendosur sipas **kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë** të avokatit mbrojtës R. G në emër të të pandehurit më 15 nëntor 2010 kundër aktgjyimit të Gjykatës Komonale në Prizren P. 385/10, të datës 25 mars 2010 dhe aktgjyimit të shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut në Prizren KP. 160/10, të datës 30 korrik 2010

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e ushtruar nga avokati mbrojtës i të pandehurit A. Z kundër aktgjyimit të Gjykatës Komonale në Prizren P. 385/10, të datës 25 mars 2010 dhe aktgjyimit të shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut në Prizren KP. 160/10, të datës 30 korrik 2010, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIMI

I. Historia e Procedurës

Me aktakuzën PP. nr. 1916/09, të ngritur nga Prokurori Komunal në Prizren më 20 gusht 2009 i pandehuri u akuzua për veprën penale të Dhënies së ryshfetit në kundërshtim me Nenin 344 paragrafin 1 të KPPK-së.

Pas pranimit të fajësisë për këto akuza i pandehuri u dënua sipas aktgjyqimit të shkallës së parë të Gjykatës Komunale në Prizren, P. Nr. 385/2010, të datës 25 mars 2010, për Dhënie të ryshfetit si ndërmjetësues dhe u dënua me 123 muaj burgim dhe me gjobë prej 2,000 Eurosh.

Pas ankesës së të pandehurit, të ushtruar më 19 maj 2010 nga avokatët e tij mbrojtës dhe ankesës së ushtruar më 30 prill 2010 nga Prokurori Komunal, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin KP. Nr. 160/2010 më 30 korrik 2010 refazoi ankesën dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Avokati mbrojtës R. G në emër të të pandehurit paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër këtyre dy aktgjykimeve më 15 nëntor 2010.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) paraqiti përgjigjen më 21 prill 2011.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme por e pabazuar.

1. Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme. Është paraqitur në gjykatë kompetente në pajtim me Nenin 451 paragrafin 3 dhe 453 të KPPK-së dhe brenda afatit ligjor të Nenit 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

2. Procedurat e përcjella nga Gjykata Supreme

Gjykata Supreme ka marrë vendim në seancë siç përcaktohet në Nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar lidhur me seancën, pasi që sipas Nenit 451 deri 460 të KPPK-së Gjykata Supreme nuk është e obliguar t'i njoftojë palët.

3. Mbi meritat e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë pretendon në shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe propozon të anulohen aktgjykimet e mëparshme dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Në veçanti, kërkesa pretendon se dispozitivi i aktgjyqimit të shkallës së parë është i paqartë dhe i pakuptueshëm, pasi që nuk specifikon sa duhet mënyrën se si i pandehuri ka vepruar si ndërmjetës, kush ka qenë pranues i ryshfetit dhe çfarë është dashur të bëjë pranuesi i ryshfetit në shkëmbim të ryshfetit të marrë. Për këtë arsye, aktgjykimi shkel Nenin 451, par. 1, pikën 2, lidhur me Nenin 403, par. 1, pikën 12 të KPPK-së.

Sipas mendimit të mbrojtjes, shkalla e parë gabimisht ka dënuar të pandehurin për veprën penale sipas Nenit 344, par. 1 të KPPK-së, në vend të Nenit 344, par. 2 të KPPK-së, sepse kjo e dyta është dispozita e saktë.

Shkalla e parë gabimisht dhe pa bazë ligjore ka shqiptuar gjobën ndëshkuese.

ZPShK-ja në përgjigjen e saj, ka propozuar refuzimin e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazë.

Lidhur me të metat e pohuara të dispozitivit, ZPShK-ja i referohet praktikës së konsoliduar gjyqësore të Gjykatës Supreme sipas të cilës vepra duhet të interpretohet në atë mënyrë që do të kishte kuptim dhe se dispozitivi i vendimit dhe arsyetimi duhet të lexohen së bashku. Nëse respektohet ky parim, del se dispozitivi është mjaft i kuptueshëm dhe i qartë.

Prokuroria konstaton se përshtatimi në të dyja aktgjykimet i përshtatet veprës penale të Nenit 344, par. 1 të KPK-së.

Lidhur me gjobën e shqiptuar, ZPShK-ja konstaton se Neni 39, par. 5 së bashku me Nenin 54, par. 1 të KPK-së autorizon shqiptimin e gjobës si dënim plotësues së bashku me parimin e dënimit alternativ.

Kundërshtimi i shfaqur lidhur me gjobën e shqiptuar është i pabazë. Gjykata Supreme pajtohet në tërësi me mendimin e ZPShK-së. Gjykoja si dënim plotësues është e bazuar në Nenin 39, par. 5, dhe në Nenin 54, par. 1 të KPK-së.

Lidhur me pretendimin e ngritur nga mbrojtja se i pandehuri është dënuar për veprën e gabuar penale, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se i pandehuri ka pranuar fajësinë për akuzat nga Neni 344, par. 1 i KPK-së. Prandaj, për këtë arsye i njëjti nuk mund të pretendojë tani se është dashur të dënohet në bazë të një dispozite tjetër penale, përveç në rastet kur i njëjti nuk i ka kuptuar si duhet akuzat gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ai nuk ka bërë një kundërshtim të tillë. Nëse të pandehurit tash – pas pranimit të fajit - i pranohet kundërshtimi se është dënuar për veprën e gabuar penale, atëherë kjo do të ishte shkelje e të drejtave. Për këtë arsye, ky kundërshtim nuk mund të qëndrojë.

Për më tepër, siç është përshtatuar edhe në propozimin e ZPShK-së, ky kundërshtim është edhe i pabazë pasi që veprimi i të pandehurit i cili trajtohet në akuzë përputhet me përshtatimin e veprës penale sipas Nenit 344, par. 1 të KPK-së. I pandehuri është dënuar për shkak se ka shërbyer si ndërmjetës për dhënien e ryshfetit personit zyrtar në mënyrë që ai të shkelë detyrën e vet zyrtare – duke shfajësuar, liruar ose shpallur dënimin e butë dhe të paarsyetuar ndaj A dhe B A, të cilët akuzoheshin për Vrasje.

Dispozitivi i aktgjyimit të atakuar është mjaft i qartë, i kuptueshëm dhe në brendi i qëndrueshëm. Përmban të gjitha elementet e nevojshme të përcaktuara prej Nenit 396 paragrafit 4 në lidhje me Nenin 391 të KPPK-së dhe nuk e shkel Nenin 451, paragrafin 1, pika 2 në lidhje me Nenin 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së. Gjykata e bazon vlerësimin e saj mbi parimin që vendimet gjyqësore duhet të interpretohen në tërësinë e tyre në atë mënyrë që janë të kuptueshme dhe që dispozitivi duhet të lexohet së bashku me arsyetimin.

Në lëndën kundër L Xh ¹, Gjykata Supreme e Kosovës theksoi:

¹ Gjykata Supreme e Kosovës, PKL.-KZZ. nr. 114/2009, Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në lëndën penale kundër L Xh, të datës 12 prill 2010

"...dispozitivi është pjesë integrale e aktgjykimit [dhe] duhet të lexohet dhe të interpretohet në lidhje me pjesët tjera të aktgjykimit, posaçërisht me arsyetimin. Duke u bazuar në parimin që vepra duhet të interpretohet në atë mënyrë që të ketë kuptim dhe jo që mos të ketë kuptim fare, dispozitivi dhe arsyetimi duhet të lexohen së bashku ..."

Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë, siç është vërtetuar me ankesën nga shkalla e dytë, në mënyrë të qartë i rendit elementet e veprës së lartpërmendur penale. Në veçanti, në mënyrë të mjaftueshme përcakton përfitimet e akorduara gjyqtarit si person zyrtar dhe rolin e të pandehurit si ndërmjetës. Të gjitha hollësitë e elementeve objektive dhe subjektive të veprës penale janë përshkruar në mënyrë të qartë dhe të shteruar në arsyetim.

Në bazë të argumenteve të lartpërmendura, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PKL.-KZZ. nr. 24/2011
Prishtinë
27 dhjetor 2011

Kryetari i kolegjit:

Procesmbajtës:

Charles L. Smith
Gjyqtar i EULEX-it

Holger Engelmann
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit:

Salih Toplica
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Martti Harsia
Gjyqtar i EULEX-it